



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 18 /2015

Prishtinë, më 05.05.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË PËRBASHKËT
E KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE
INDUSTRI, ME KOMISIONIN PËR LEGJISLACION, MANDATE, IMUNITETE,
RREGULLOREN E KUVENDIT DHE MBIKËQYRJEN E AGJENCISË KOSOVARE
KUNDËR KORRUPSIONIT**

Në këtë mbledhje të përbashkët morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Duda Balje, Albulena Haxhiu, kryetare, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Donika Kada- Bujupi anëtarë dhe Margarita Kadriu - Ukelli deputete e pavarur.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Enver Hoti, Selvije Halimi, Agim Ademaj dhe Milena Milićević – anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Skender Krasniqi, Lumnije Ajdini dhe Hysni Zogaj- AKB; Lumnije Hashani-OEK; Visar Hapçiu - OEAK; Azem Rexhaj- OEGJK; Petrit Balija- SHBK; David Greer dhe Ardian Kryeziu - USAID/CLE; Dardan Abazi – INDEP; Arta Xhylani, Besa Berisha, Zahir Qerkini dhe Hamit Mjeku – UNDP (praktikantë).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesuan kryetarët e Komisioneve z. Muhamet Mustafa dhe znj. Albulena Haxhiu.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata.

Kryetari i Komisionit z. Muhamet Mustafa – Tha se në marrëveshje me znj. Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, jemi marrë vesh që ta ftoj një mbledhje të përbashkët, që të jetë një mbledhje nismëtare për të trajtuar këtë çështje shumë të rëndësishme, e cila është në agjendë e të dy komisioneve dhe ndërlihet në mënyrë substanciale me nevojën e krijimit të një mjedisi më të fortë edhe më të mirë investues dhe nga ana tjetër, gjithashtu ndërlihet edhe me forcimin e sundimit të ligjit edhe zbatimit të shtetit ligjor. Duke u nisur nga një qëllim themelor që e kemi në Komisionin tonë që të bëjmë gjithçka është e nevojshme në fushën e iniciativave, legjislacionit, të politikave, të monitorimit të të gjitha këtyre, të përqendruara në nxitjen e investimeve dhe të rritjes ekonomike, kemi konsideruar se çështja e një efikasiteti më të madh në adresimin e kontesteve biznesore në gjykata ka rëndësi esenciale. Ju keni marrë disa informata initiale nga shoqatat e bizneseve dhe një informatë të shkurtë nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës. Prej këtyre çështjeve ishte një hulumtim i Odës Austriake ku thotë siguria ligjore dhe mbrojtja e investimeve është një problem serioz për 80% të bizneseve në Kosovë, pastaj Shoqata e Bankave, kanë diku 10 mijë e 500 lëndë në gjykata me një vlerë rreth 250 milionë euro. Shembujt e dhënë këtu japin të mësojnë se kontestet biznesore zgjatin (6-7) me vite. Përpjekjet që të afirmohet arbitrazhi dhe format alternative të zgjedhjes së kontesteve biznesore nuk kanë dhënë rezultate të pritura. Gjithashtu, nga materiali i dërguar nga Këshilli Gjyqësor mësojmë se ata mendojnë se është bërë një kthesë, sigurisht që është bërë një kthesë në krijimin e Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Divizionit Fiskal dhe me Përmbaruesit privatë. Sigurisht që ky është një hap i rëndësishëm, por situata në perceptimet e bizneseve dhe situata konkrete është ende jo e mirë dhe ky paraqet një nga problemet esenciale për të rritur investimet. Rritja e investimeve në Kosovë është çështje numër një. Çështja numër një sepse nëse e shihni nivelin e investimeve në Kosovë aty sillen diku rreth 20-22% GDP së Kosovës, së paku i duhet që të rriten investimet deri në 30-32 të GDP për të gjeneruar rritjen ekonomike dhe punësimin dhe për të krijuar një mjedis sa më të favorshëm për investime. Në qoftë se 80% e investitorëve të jashtëm e konsiderojnë problem sigurimet ligjore, mbrojtjen e kontratave, mbrojtjen e investitorëve mendoj se ky duhet të jetë një lloj alarmi për të gjithë neve edhe për Kuvendin, edhe për Qeverinë, edhe për gjyqësorin, por sidomos për gjyqësorin. Kryetari tha se detyra jonë, si Kuvend është që këto kontekste që zgjasin disa vjet patjetër duhet t'i sjellim në një kohëzgjatje prej disa muajve, përndryshe ne nuk mund të pretendojmë që do të kem një klimë të shëndoshë biznesi dhe nuk mund të pretendojmë që do të kemi investitorë në Kosovë. Gjithashtu kemi edhe përfaqësues të një projekti që udhëheq USAID që kanë të dhëna, kanë shifra të cilat ne do t'i përdorim në hartimin e raportit të fundit me rekomandime.

Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit - Tha se sot jemi bashkë dy komisionet, Komisionin për Legjislacion dhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, që së bashku t'i adresojmë sfidat dhe problemet me të cilat përballen bizneset në raport me gjykatat. Fillimisht më duhet të ju informojë që unë sot në mëngjes jam njoftuar që kryesuesi i KGJK, zoti Enver Peci, nuk do të jetë i pranishëm në këtë mbledhje. Edhe pse ftesa i ka shkua më 29 prill dhe besoj që ka pasur mjaftueshëm kohë që ta trajtojë me seriozitet pjesëmarrjen në këtë mbledhje të përbashkët duke e ditur rëndësinë që ka sot ky takim. Përmes shkresës Këshilli Gjyqësor na ka informuar që Departamenti për Çështje Ekonomike ka kompetencë në gjykimin e rasteve eventuale të bizneseve dhe se i njëjti është ngarkuar me shumë numër të madh të lëndëve dhe që procedurat janë të tej zgjatura. Në letrën e proceduar nga Oda Ekonomike Amerikane vërejtja që kanë cilësuar si hap të gabuar transferimin e kompetencave për çështje doganore dhe tatimore të Gjykatës Themelore. Mirëpo, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e konsideron si të drejtë, pra themelimin e këtij divizioni dhe kanë thënë që ka gjyqtarë të profilizuar dhe i zgjedhin kontestet në një afat shumë të shkurtër dhe të shpejtë. Besoj, që ndoshta do të kem informacione se pse e kanë konsideruar si hap të gabuar themelimin e këtij Divizioni për Çështje Doganore dhe

Tatimore. Pas kësaj informate të përgjithshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sërish i kam dërguar letër Këshillit Gjyqësor dhe i kam kërkuar një raport më të detajuar në lidhje me këto çështje, mirëpo ende nuk është sjellë. Besoj që është tejet e rëndësishme që të njoftohemi për të dhënat lidhur me zgjidhjen e lëndëve në sektorin e gjyqësisë, sepse nëse veprimet siç kemi vepruar deri më tani ose nuk informohemi siç duhet, neve po na pamundësohet që të kemi një pasqyrë reale karshi nevojave të bizneseve dhe e kufizon kontributin tonë si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që me rastin e rishikimit të ligjeve t'i adresojmë problemet konkrete që i prekin bizneset. Pra, ne po presim, me që ky është një takim i parë dhe nuk është i fundit, ne po presim që të pajisemi me një raport më të detajuar siç thotë kryesuesi i Këshillit Gjyqësor më ka thënë që do ta procedojë sa më shpejt këtë raport të detajuar dhe sigurisht që do ta mirëpresim dhe do ta diskutojmë bashkë dhe do të ballafaqohemi me problemet dhe me sfidat që i kanë bizneset karshi gjykatave në një takim tjetër të ardhshëm.

Petrit Balija, Shoqata e Bankave të Kosovës - Tha se synimet e Shoqatës së Bankave janë që fillimisht të krijojmë një mjedis më të favorshëm në mënyrë që të joshim edhe banka të reja që të vijnë në Kosovë dhe të rritet konkurrenca. Në këtë drejtim kemi identifikuar disa probleme: Krahas shumë faktorëve të tjerë të riskut me të cilët ballafaqohet sistemi bankar në Kosovë, sistemi i drejtësisë paraqet një prej sfidave kryesore i cili rrit ndjeshëm ambientin e riskut në të cilën vepron sektori bankar, ku sipas raporteve zyrtare Kosova listohet në vendin 138 për zbatimin e kontratave nga gjithsejtë 189 vende në ranglistë. Dhe për sistemin bankar zbatimi i kontratës është një instrument jetik me të cilin funksionon ky sektor. Tri sfidat kryesore në sektorin e drejtësisë i kemi identifikua janë: lëndët e papërfunduara të cilat presin me vite, kemi lëndë më të vjetra se gjashtë vite duke pritur në gjykata; zbatimi jo adekuat i ligjeve në fuqi, pra interpretimi i ndryshëm edhe do t'i ceku disa shembuj dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe stafi profesional në gjyqësor. Sistemi bankar aktualisht numëron rreth 10.500 lëndë që janë në gjykata të pazgjedhura, ose të pa trajtuara dhe kjo paraqet një vlerë diku 250 milionë euro të bllokuara që nuk janë në qarkullim dhe në funksion të ekonomisë së Kosovës. Kemi disa shembuj, deri në vitet e fundit nuk kemi pasur njohjen e hipotekës si titull ekzekutiv që për fat të mirë tani më është çështje e zgjidhur, por ka dëmtua shumë procesin e zhvillimit në sektorin bankar. Moszbatimi i kamatëvonesës dhe trajtimi i saj si joligjore në Kosovë paraqet një dëmtim shumë të madh të sistemit bankar dhe një shkelje të të drejtave të biznesit. Me konventa dhe direktiva evropiane lejohet dhe është parim shumë i pranueshëm për ngarkesën e kamatëvonesës në rastin e vonesave të kredive ose mos pagesave me kohë. Prandaj, edhe në Kosovë duhet që të respektohet çështja e kamatëvonesës dhe mos të trajtohet si e jashtë ligjshme. Përmbaruesit privat kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimet në sektorin bankar dhe mund të themi se USAID-i së bashku me Ministrinë e Drejtësisë kanë bërë një punë shumë të mirë. Por kërkojmë që në amendamentimin e radhës së Ligjit për përmbaruesit privat të qartësohet edhe çështja e ngarkesës me tarifën e suksesit që po ngarkohet para inkasimit të mjeteve. Një çështje tjetër që vlen të ceket janë edhe problemet që krijohen si mungesë e burimeve njerëzore dhe stafit profesional në gjyqësor. Mendojmë se nuk ka mjaftueshëm gjyqtarë të profilizuar për të trajtuar rastet specifike të natyrës së sektorit financiar. Si rekomandime nga Shoqata e bankave të Kosovës do të thoshim që është mirë të krijohet një grup ose task-forca apo një departament i veçantë i cili do të trajtonte lëndët e sistemit bankar duke pasur parasysh vëllimin e madh të tyre dhe vjetërsinë e tyre në mënyrë që të zhblllokohet kjo situatë. Nëse nuk është e mundur të krijohet një task-forcë apo grup i veçantë për këto lëndë, atëherë një alternativë tjetër është që të përdoret modeli i Maqedonisë ku për njohjen e kontratës mbi hipotekën si titull ekzekutiv dhe i zbatueshëm bëhet një marrëveshje me një akt noterial dhe kështu evitohet krejtësisht shkuarja në gjykatë.

Skender Krasniqi, nënkryetar i Aleancës Kosovare e Biznesit – Tha se shpreh keqardhjen për mungesën e Këshillit Gjyqësor që të jenë prezentë dhe t'i dëgjojnë problemet e bizneseve dhe rastet të cilat paskan deklaruar se janë duke i zgjedhur shumë mirë. Mendojmë se pas politikave

jo adekuate me qeveritë e Kosovës deri më tani me të gjitha qeveritë, gjykatat janë një nga faktorët më të rëndësishëm që ka ndikuar dhe po ndikojnë në mos zhvillimin e vendit tonë. Nëse qeveritë e deritanishme nuk kanë arritur që t'i nxisin bizneset vendore dhe të huaja për të rritur investimet, gjykatat kanë arritur që me zhagjitjet e lëndëve me muaj dhe me vite të japin një kontribut të jashtëzakonshëm në dekorajimin e biznesmenëve vendorë dhe të huaj. Mungesa, mosfunksionimi i gjykatave i ka dëmtuar në masë të madhe edhe biznesin medial. Si pasojë e kësaj mund t' i themi disa statistika. Prej vitit 2010-2014 janë regjistruar 41 mijë e 112 biznese të reja, 6647 prej tyre janë mbyllur. Në vitin 2014 39.4% e bizneseve të regjistruara të huaja janë mbyllur, plus 20 % vendore, domethënë nga raporti që e kemi bërë një statistikë të Aleancës Kosovare të Biznesit një hulumtim. Vetëm në vitin 2014 janë lëshuar 4000 kompani, në qoftë se veç këto i kanë nga dy punëtorë janë mbi 8 000 punëtorë që kanë mungesë. Një hulumtim i grupit për studime juridike dhe politike që ka bërë dje që është bërë gjatë muajit mars 37% e qytetarëve janë të gatshëm të migrojnë si pasojë e këtyre. E kemi rastin e Fantimellit, ta zëmë shtatë vjet ka zgjatur gjykata me zgjidh një problem nga 2007-2014, ka qenë veç mu konfirmuar pozita e tij, ju ka ndërruar statusi. Rasti i Solidit është në gjykatë mbi dy vjet zgjatë diferenca mbi një milionë euro. Rasti i Minierës së Goleshit, që gjashtë muaj është rasti në gjykatë, 200 punëtorë janë larguar prej pune. Biznesi ka pasur dy ditë më vonë me hapë biznesin me hapë ndërmarrjen, dy ditë më herët është shkuar ju ka mbyllur, janë largua mbi 200 punëtorë, 100 prej tyre janë larguar jashtë me autobusë në Hungari, janë investuar dhjetëra mijëra euro në atë lëndë që punëtorët me u përgatitur për punë dhe ata sot janë jashtë. Janë humbur mbi 100 milionë investime që e ka marrë nga jashtë dhe nuk kanë mundur kur me ardhur në Kosovë si pasojë e kësaj.

Visar Hapçiu, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë - Tha se realisht duhet me thënë që në përgjithësi vitet e fundit kemi parë një përmirësim të sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe kjo falë të disa iniciativave dhe disa reformave që janë bërë. Prej më të rëndësishmeve ndoshta i kisha përmendur hyrjen në funksion të arbitrazhit të ndërmjetësimit, si dhe hyrjen në fuqi të punës së përmbaruesve privat. Sa i përket çështjes që e përmendi më herët deputetja Haxhiu, lidhur me riaktivizimin e Bordit të pavarur është pikërisht ajo arsyeja pse ne po kërkojmë është që besojmë fuqishëm dhe mendoj se krejt biznesit është unanim në këtë pikë që mungon ekspertiza për t' i zgjidhur çështjet konkrete të natyrës fiskale dhe doganore. Kjo është një kërkesë që ndoshta me u bë një anketë me shumë biznese, një numër tepër i vogël kish me thënë që nuk është problem serioz, meqenëse siç e ceku zotëriu, për shembull e merr ndonjë, e ka ndonjë borxh që i shqipton dogana ndonjë dënim dhe mandej shkon me vite e vite deri sa ai kontekst të zgjidhet edhe në ndërkohë biznesi dëmtohet.

Lumni Hashani, Oda Ekonomike e Kosovës - Tha se Oda Ekonomike e Kosovës e sheh shumë të rëndësishme këtë tryezë të sotme ku diskutohen sfidat me të cilat ballafaqohet komuniteti i biznesit në raport me sistemin gjyqësor të Kosovës. Bizneset në Kosovë zgjatin me vite të tëra dhe investitorët e huaj nuk dëshirojnë të futen në një midis biznesor ku kontesteve nuk iu dihet fundi dhe ajo që e dëmtun më së tepërmi mjedisin biznesor në Kosovë është stërzgjatja e zgjidhjes së këtyre kontesteve. Në anën tjetër janë hezitimet në implementimin e vendimeve të gjykatave bën që bizneset ndërkombëtare të hezitojnë të futen në një treg të tillë. Andaj, duke e parë që gjykatat dhe problemet që dalin si rezultat i mos funksionimit të gjykatave rritin koston dhe ulin pozitën konkurruese të ndërmarrjeve në Kosovë dhe rrjedhimisht e shndërrojnë Kosovën në një mjedis jo të favorshëm për investitorët e huaj. Oda Ekonomike e Kosovës e ka bërë një raport, të cilën ia ka dërguar Komisionit për Zhvillim Ekonomik ku paraqiten shumë biznese, të cilat kontestet e tyre, në raport me gjykatat si Gjykatën Themelore ashtu edhe Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme zgjatin me vite të tëra. Duke u nisur në periudhë prej 1 deri në 7 vjet. Andaj, duke i parë këto sfidat me të cilat po ballafaqohet sistemi gjyqësor në Kosovë ne kërkojmë që institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve të sigurojnë efikasitet në zbatimin e kontratave të trajtojnë me prioritet kontestet ekonomike, të sigurojnë

zbatim të barabartë të legjislacionit, të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar ekonomik. E dyta, kërkojmë rritjen e numrit të gjyqtarëve të cilët janë të specializuar për konteste ekonomike dhe gjithashtu kërkojmë që të bëjë promovimin e gjykatës së arbitrazhit e cila vepron në Kosovë, në rast se bizneset janë të ngarkuara në rast se gjykatat janë të ngarkuara me konteste biznesore atëherë alternativa më e mirë është që biznesit t'i drejtohen gjykatës së Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike dhe asaj Amerikane, e cila është një rrugë shumë më e shkurtër në zgjidhjen e këtyre kontesteve.

Azem Rexhaj, Oda Ekonomike gjermano-kosovare - Tha sa pa i përsëritur të gjithë kolegët nga odat e tjera, mirëpo do të ndalem te çështja e Gjykatës Ekonomike domethënë edhe anëtarët e Odës Ekonomike gjermano-kosovare kanë ngritur si çështje shqetësuese vonesat që ndodhin kryesisht nga në marrjen e vendimeve të gjykatave dhe për shkak të këtyre vonesave nganjëherë kur kemi të bëjmë investitorët e huaj dhe investitorë vendorë pavarësisht nëse vendimi i gjykatës merret i drejtë, mirëpo nëse ai vendim merret pas disa viteve investitorët e huaj do të thotë me automatizëm krijojnë një ndryshim që gjykata është kah krijon një vonesë për shkak se me favorizuar do të thotë një palë ose një palë tjetër. Dhe për këtë arsye do të thotë një prej kërkesave kryesore do të thotë të anëtarëve të Odës Ekonomike gjermano-kosovare është që të shikohen mundësitë që gjykatat të jenë më efektive. Për momentin Gjykata Ekonomike siç jemi informuar ka vetëm tre gjyqtarë. Duke pasur vetëm tre gjyqtarë është e pamundur që të realizohen ose të merren në shqyrtim të gjitha lëndët e bizneseve do të thotë pavarësisht nga cilat drejtime vijnë. Po ashtu, do të thotë me rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe me angazhimin e gjyqtarëve të specializuar në çështje ekonomike mund të ndodhë që do të ketë pastaj edhe një profesionalizëm më të lartë në zgjidhjen e kontesteve ndërmjet bizneseve edhe përkundër që me përmbaruesit privat, pastaj me arbitrazhin domethënë është bërë përparim në zgjidhjen e disa çështjeve, mirëpo vonesat që ndodhin kryesisht në Gjykatën Ekonomike dhe në gjykatat tjera po shkaktojnë siç thashë dilemat, dyshime që edhe nëse zgjidhet kontesti pas 5 viteve 6 viteve investitori i huaj nuk e pret. Sepse, ai po krijon dyshime qysh në fillim do të thotë që ka një anshmëri ose një vonesë të qëllimshme. Domethënë kjo ishte në pika të shkurta.

Besim Beqaj - Tha se sigurisht është një ndër takimet më të rëndësishmet që besoj që si Komision dhe si dy komisione bashkërisht jemi duke i trajtuar. Fatkeqësia është që ne nuk e kemi këtu Këshillin Gjyqësor të Kosovës i cili do të duhej të na jepte një pasqyrë reale dhe ne jemi duke zhvilluar edhe pse jemi shumë njerëz, njëfarë lloj monologu me njëri-tjetrin duke ia qarë hallet për diçka, për të cilën ne nuk kemi asnjë nga kompetentë këtu. Unë i kam shqyrtuar me kujdes edhe i kam lexuar të gjitha vërejtjet që kanë ardhur nga asociacionet e biznesit. Një numër i madh i tyre kanë bazë të mirë, por jo gjithmonë edhe kanë të drejtë edhe duhet të kuptohemi këtu u përmend çështja nga shoqata e bankave që do të duhej të kishte ndoshta një sektor të veçantë për banka që më duket që është pak e tepruar. Ne nuk mund të krijojmë sektorë të veçantë për secilin veç e veç, besoj se çështja kyçe që duhet të trajtojmë janë dy gjëra, një këshilli gjyqësor të rritë numrin e gjyqtarëve në kuadër të Departamentit për çështje ekonomike sepse nuk kemi gjykatë ekonomike dhe të cilët duhet të jenë kompetentë de t'ju caktohet afat kohor. Unë besoj që afati kohor për trajtimin e lëndëve do të ishte një instrument i cili shtynë më fuqishëm gjykatat me vepruar. Dhe ana tjetër është promovimi i arbitrazhesh të cilën USAD-i bashkë me dy odat ekonomike Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën Ekonomike Amerikane ka promovuar. Pra, unë po propozoj që ne të dëgjohemi sot me njëri-tjetrin, por realisht pa e pasur Këshillin Gjyqësor të Kosovës këtu i cili do të duhej të na jepte arsyet sa është përmirësuar, ka dilema edhe për përmbaruesit privat, edhe për funksionimin e tyre. Po ju flas edhe nga këndvështrimi i ish- ministrit të Financave nuk është se kanë problem me buxhetin, nuk kanë probleme në kuptimin, sepse për çdo vit së paku i kanë nga 200 gjyqtarë të cilët nuk i kanë të punësuar, po ju flas me një kompetencë të plotë. Për çdo vit, po ju mbaron viti fiskal me së paku 200 vende të punës, të cilat janë të paplotësuar, pra është çështje e menaxhimit dhe është çështje do të thotë e trajtimit me prioritet. Pra, në këtë drejtim unë po besoj që shumë shpejt do ta bëjmë

një takim ku do të jetë edhe Këshilli Gjyqësor edhe pse jo edhe Ministria e Drejtësisë, sepse fundi i fundit ata janë krijues të politikave.

Kryesuesja - Vetëm diçka sa i përket buxhetit, as 2% e total buxhetit të shtetit nuk ndahet për sistemin e drejtësisë, është 1.90%, pra as 30 milionë në total nuk ndahet për sistemin e drejtësisë. Ka pasur kërkesa për rritjen e gjyqtarëve, mirëpo këto nuk janë aprovuar, si dhe ka pasur kërkesa për rritjen e stafit profesional për të cilën edhe këtu diskutuam sepse nuk ka staf profesional ose mungon ekspertiza nga stafi profesional në gjykata. Theksoj, se konsideroj që është tepër problem sa i përket përmbaruesve privat me ju thënë të drejtën nuk e di nëse përmbaruesit privat janë duke vepruar siç duhet. Unë kam kundërshtuar në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, sepse kjo është mënyrë kërcënuese për mbledhjen e borxheve. Pra, ju e patë edhe dje në KTV ju ka ndalë edhe pensioni një qytetari, kjo është e tmerrshme. Pra, besoj që e kemi obligim që t’ia adresojmë këto çështje, sepse dakord jam për forcimin e bizneseve për adresimin e sfidave mirëpo, jo duke i cenuar interesat e qytetarëve, të cilët po luftojnë për minimumin jetik.

Armend Zemaj - Tha se jemi mbledhur që të diskutojmë çështjet që duhet t’i shohim në mënyrë të përgjithshme, sepse edhe nga mandati na takon që jemi përfaqësues të gjithë qytetarëve të vendit, që të arrijmë deri te një konkluzion se çka mund të bëjë Kuvendi në avancimin e problematikave të ndryshme që u paraqitën, qoftë nga raportet që i kemi këtu nga Këshilli Gjyqësor, por edhe nga asociacionet e bizneseve, të cilat në fjalën e tyre po thuajse trajtuan temë gati të njëjta me nuanca, kërkesa që i kanë edhe personale, por mbi të gjitha të arsyeshme dhe të evidentuara me fakte që këta i paraqesin para komisionit dhe në raporte të tyre. Por, tash mendoj që nuk duhet të jemi vetëm spektatorë, si Kuvend, por duhet të ndërhyjmë mendoj edhe si mënyrë raportimit, kërkesës për llogaridhënie ashtu siç na takon me Kushtetutë, sepse shtylla e gjyqësorit është e pavarur dhe ne shpresojmë që edhe vendimet e tyre janë të pavarur, por ajo që po shihet edhe nga këtu që u deklarua edhe ajo që po shihet në praktikë nuk është e pavarur, ka ndërhyrje dhe mbi të gjitha ka edhe afera korruptive. Neve, si Kuvend, na ka takuar që së paku ta bëjmë punën tonë që është paraqitur si vizion i reformimit të drejtësisë duke hartuar apo duke kompletuar legjislacionin i cili tanimë është në fuqi dhe po potencohet edhe këtu, por edhe nga raportet e mekanizmave ndërkombëtarë se ka arritur së paku të bëjë pak progres. Ajo që është duke marrë parasysh miratimi i Ligjit për gjykatat apo ri organizmi i gjykatave që ka qenë, Ligjit për procedurën përmbarimore, Ligjin për noterinë, Ligjin për arbitrazhin dhe Ligjit për ndërmjetësimin. Unë dua me ndërlidh tash në këtë aspekt edhe nga kërkesa edhe nga debati që u paraqit këtu. Ajo çka më intereson mu si përfaqësues i qytetarëve, si politikan mbi të gjitha pa marrë parasysh profesionet çfarë i kemi, është që t’i shohim apo t’i rishikojmë raportin e bizneseve private dhe institucioneve publike. Tash pse po e përmendi këtë, qoftë njëherë anë qoftë anasjelltas, edhe kontestet që zhvillohen mes tyre. Unë më kujtohet njëherë në një debat kam qenë, nuk e di 2011 ndoshta, i ftuar nga ish- komisioni që ka qenë për Zhvillim Ekonomik, një biznes i cili ishte serioz edhe për nga investimet kishte bërë një investim të madh diku këtu në hyrje të Prishtinës një ndërtim këtu hyrje-dalje, kishte përfituar nga ai biznes diku 9,10,12 milionë, mos ta apostrofoj me shifra, por nuk kishte arritur që ta përfundojë punën dhe kishte konkurruar për punë shtesë. Domethënë, këtu logjika për mu personalisht mendoj që aty ka pasur aferë korruptive dhe tash ky është relacioni i biznesit që e ndërton qysh në start që kërkon me krye një punë, një investim, sepse puna shtesë ka rezultuar pas 20% që ai siç duket e ka dhënë në tavolinë dhe nuk ka mundur me arritur me krye punën e vet. Dhe, ai e ka paditur shtetin. Tash, duke paditur shtetin kontestet që janë me shtetin zgjidhen në mënyrë shumë të shpejtë, tash edhe unë këtu e kam një dilemë, si po arrijnë bizneset që duke paditur shtetin ato konteste zgjidhen shumë shpejt dhe ato para, domethënë, ju bllokohen ministrive të caktuara të linjës, qoftë të komunave dhe ato shumë shpejt transferohen në llogaritë e tyre bankare. Këtu tregon që ne nuk kemi të bëjmë vetëm me njëanshmëri, por kemi të bëjmë me një lidhje që mund të jetë korruptive, por mos ta banalizoj ose mos ta ngarkoj shumë kriminale e cila dëmton taksat e

qytetarëve të vendit duke u marrë prapëseprapë dyfishin, sepse ai njëherë po paguan për të investuar, e dyta po jap prapë për me paguar dëmshpërblimin. Unë mendoj që institucionet bankare duhet të reformohen pikë së pari të punojnë për interesat të qytetarëve mbi të gjitha, por jo të punojnë vetëm për interesa të tyre personale edhe ne e dimë gjithë që cili është perceptimi për institucionet bankare në vend dhe cili është raporti qytetar- institucion bankar. Sepse, duke marrë parasysh, qoftë kamatat, qoftë çështjet administrative, teknike, qoftë institucionale ju e dinin se sa taksa mblidhni, çfarë forme për një shërbim për të gjitha këto. Mendoj, që këto janë disa çështje që mendoj që nuk kanë të bëjnë vetëm me një anshmëri, por kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të qytetarëve të vendit. Komisionet për Legjislacion dhe Komisionet për Zhvillim Ekonomik i takon që të jetë i paanshëm, domethënë në raport mes juve dhe gjyqësorit. Pa marrë parasysh interesave politike qofshin ato edhe biznesore që mund të jenë interesa të deputetëve të caktuar, apo të grupimeve politike. Vërejtjet te gjykatat tash edhe unë po e shoh që po të ishin këtu ne po e kemi mundësinë edhe si komision ta theksojmë, fatmirësisht do ta përcjellim një ligj i cili është për parandalimin e konfliktit të interesit, ndoshta kjo do t'ju shërbej edhe juve për informim që këto punë shtesë që janë bërë trend në Kosovën e pasluftës mendoj që t'i eliminojmë me këtë që po të ishin këtu ne po e kemi mundësinë edhe si komision ta theksojmë, fatmirësisht do ta përcjellim një ligj i cili është për parandalimin e konfliktit të interesit, ndoshta kjo do t'ju shërbej edhe juve për informim që këto punë shtesë që janë bërë trend në Kosovën e pasluftës mendoj që t'i eliminojmë me këtë. Ne kishim një raport të Institucionit të Institutit Gjyqësor të Kosovës, i cili merret me trajnimin, faktikisht të gjyqtarëve dhe nga 145 ditë, 72 gjyqtarë, prokurorë, nivele të larta të profileve të larta, domethënë kanë trajnuar dhe kanë dhënë mësim aty, ku mos me u grumbulluar lëndët. Por, ky nuk është problem i juve ky është problem i Kuvendit, është problem i Këshillit Gjyqësor dhe në këtë aspekt mendoj që duhet të dalim me rekomandime të sakta, me rekomandime konkrete dhe t'i shohim dhe t'i eliminojmë këto defekte.

Margarita Kadriu – Ukelli - Tha se ne realisht në vazhdimësi do të thotë për vite të tëra po dëgjojmë ankesat e komunitetit të biznesit, të cilët kanë shprehur sidomos shqetësimin lidhur me shuarjen e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, si organ i ri administrativ dhe kalimit të përgjegjësi të këtij bordi në Gjykatën Themelore, gjegjësisht në Departamentin Administrativ divizioni fiskal, ku nga data 1 dhjetor 2012 të gjithë e dimë kanë të gjitha ankesat kundër Administratës Tatimore apo Doganave janë adresuar kësaj gjykate. Në shkresën e kryesuesit të KGJK-së drejtuar Komisionit për Legjislacion ai mes të tjerash thekson se rastet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Divizioni Fiskal gjykohen nga gjyqtarët e profilizuar dhe brenda një afati relativisht të shpejtë, thotë ai. Por, realiteti të gjithë e dimë flet ndryshe, tërësisht ndryshe. Pra, këtu bëhet fjalë për një të pavërtetë, sepse lëndët presin me vite të tëra, mrrizojnë në atë gjykatë, sepse kush lodhet në fund të fundit për të tilla biznese që nuk janë në klubin e oligarkëve, që nuk janë të lidhura me pushtetin, e prandaj mos pritni as gjyqtarët që KGJK-ja që do të lodhen për këtë punë. Këtë po e thonë në vazhdimësi bizneset, por edhe në raportin që e kishte bërë Zyra Tregtare Austriake kishte nënvizuar dhe një fakt se si brenda një gjykate apo nga i njëjti gjyqtar vendoset në mënyra të ndryshme për rastet të cilat janë tërësisht të njëjta, komplet të ngjashme. Rastet të tilla dhe mënyra të tilla të gjykimit fatkeqësisht në Kosovë janë të përditshme në gjykatat kosovare, duhet theksuar dhe një fakt se koha e stërzgatur për trajtimin e ankesave të biznese paraqet edhe shkelje serioze të parimeve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Vendimi për shuarjen e Bordit të pavarur, do të thotë ka qenë një gabim i radhës së ish -qeverisë andaj, përderisa bordi përbëhet nga njerëz profesionistë të fushës realiteti po tregon se gjyqtarët nuk po i njohin këto çështje, sepse nuk i kanë njohur. Prapë, kush po humb? Sërish po humbin bizneset që nuk janë të lidhura me oligarkët, gjegjësisht me pushtetin nuk janë në atë klub. Prandaj, kërkesën për riaktivizimin e Bordit të Pavarur është kërkesë e cila unë mendoj që duhet përkrahur. Edhe pse Ministria e Drejtësisë me shumë pompozitet e lansoi se përmbaruesit privatë do të thotë do t'i ndihmojnë sistemit të drejtësisë, por realiteti po flet krejt ndryshe. Bizneset po ankohen se ka

shumë përmbarues pa integritet profesional, të cilët për qëllim përfitimin personal po bëjnë shitblerje të drejtësisë. Për ma tepër, do të thotë ky është një lajm i ri që një pjesë e madhe e përmbaruesve janë njerëz që kanë qenë në marrëdhënie pune e disa janë ende në marrëdhënie pune me oligarkë të lidhur me pushtetin. E njëjta dukuri ka ndodhur në periudhën e pasluftës, kur njerëzit sistemoheshin në dogana, në administratën tatimore, për t'u pozicionuar. E njëjta po ndodh, pozicionimi të përmbaruesit privat. Pra, prej një ekstremi, kur vendimet e plotfuqishme të gjykatave nuk përmbroheshin, kur gjykatësit e caktuar për përmbarim u merrnin bizneseve 5 mijë euro, tani kemi ardhur në një situatë tollovie, që ngjanë me gjuetinë e shtrigave, kisha me e quajtur unë, ku për shkak të parave, pa ua bërë verifikimi profesional i dokumenteve të besueshme, ku përmes falsifikimeve të ndryshme, për të cilat ka argumente, përmbaruesit po dëmtojnë bizneset. Andaj, trajtimi joprofesional dhe pa etikë, që po bëhet nga një pjesë e përmbaruesve privatë, po i dëmton bizneset. Mungesa e sundimit të ligjit po ndikon, që për rritje të investimeve në vendin tonë për momentin, vetëm të ndërrojnë. Për ta përfunduar, në mungesë të sundimit të ligjit mos efikasitet të sistemit gjyqësor, me norma të larta të interesit bankar, me mosdhënie të licencave në mënyrë të ligjshme, por vetëm për oligarkët e lidhur me pushtetin, me monopol, me korrupsion, me energji të shtrenjtë e shumë defekte të tjera, i nderuar, investimet, qofshin ato vendore apo të huaja, vetëm do të zvogëlohen.

Pal Lekaj -Tha se është një temë që duhet një trajtim i veçantë dhe nga kontaktet që i kemi pasur edhe ne, si Komision, me të gjitha odat, me biznese, të njëjtat gjëra po përsëriten edhe sot dhe janë shqetësuese edhe për sistemin e drejtësisë, por edhe për vetë qytetarët, e sidomos për sistemin e shtetit. Ajo që e përmendi, do të thotë 10 mijë lëndë të pazgjidhura, të pa trajtuara, do të thotë, a s'do thotë që me të vërtetë kemi një sistem gjyqësor joefektiv, joefikas dhe joprofesional. Tjetra është që e përmendi AKB-ja, që me të vërtetë është shqetësuese mbyllja e shumë bizneseve. Zoti Beqaj e përmendi që ka buxhet, por sa herë që kam takuar kryetarë të gjykatave apo zyrtarë të lartë të drejtësisë, mungon buxheti dhe mungon financimi për drejtësi dhe kjo është neglizhencë e Qeverisë apo e tërë sistemit për të mbështetur drejtësinë dhe aty ku nuk ka efikasitet në gjyqësi nuk ka trajtim të paanshëm, mendoj që kot ne flasim për t'i mbështetur bizneset. Ajo që mund të them, ne e kemi trajtuar edhe çështjen e efikasitetit për të bërë biznes, jemi lavdëruar, gjoja se jemi ngritur për sa vende, mirëpo në praktikë mendoj se është e kundërta dhe është shqetësuese. Prandaj, ne këtu jemi mbledhur për të marrë rekomandimet e juaja dhe për ta lehtësuar bërjen biznes në Kosovë. Dhe, këtë mund ta bëjmë vetëm duke ofruar ligje, që janë në shërbim të biznesit, e jo në shërbim të individëve të caktuar, ku masa e korrupsionit e ka arritur maksimumin dhe për të bërë biznes në Kosovë, mendoj se duhet shumë, nëpër shumë dyer, nëpër shumë xhepa që ne të japim para të majme dhe kush e di ku, si trajtohet dhe a mund të fillojë biznesin. E patëm çështjen e Goleshit, a nuk është kur përmenden qindra milionë euro në Kosovë për investime dhe mendoj që është e padrejtë të atakohet një biznes i tillë, sepse janë qindra familje që punësohen dhe mendoj se në këtë drejtim prapë nuk po kemi politika të shëndosha, për mbështetje të biznesit. Dhe kjo, mendoj se është punë e Parlamentit të Kosovës duke mos ndërhyrë në pavarësinë e gjykatave, por ne të biem ligje që shkojnë në favor të qytetarëve, e jo në favor të individëve të caktuar apo të krijojmë hapësirë për korrupsion me vetë miratimin e ligjeve, apo me vetë mos saktësinë e një çështje që rregullohet me ligj. Prandaj, të gjitha këto mendoj që ne duhet t'i trajtojmë ashtu siç duhet dhe janë një mesazh i qartë edhe për Parlamentin e Kosovës edhe për Qeverinë, që urgjentisht ne duhet të fillojmë plotësim-ndryshimin e ligjeve.

Visar Ymeri - Tha se do ta kisha zgjeruar pak temën, meqenëse po flasim tash për një si me thënë, ravijëzim të them ashtu, të agjendës së takimeve, diskutimeve rreth kësaj çështjeje, për të përfunduar me një rekomandim për Kuvendin. Mendoj që çështja e parë që duhet të diskutohet dhe që filloi këtu të diskutohet, është nëse sistemi i drejtësisë aktualisht i ndërtuar në Kosovë me funksionimin e vet krijon hapësirë barazie për të gjithë njësoj, pra sikur për ta zëmë pronarët e bizneseve, sikur për bizneset individuale, po ashtu edhe për qytetarë. Sepse, detyra parësore e një

sistemi drejtësie është që ai të ndajë drejtësi, barabarësisht për të gjithë qytetarët e vendit dhe të mos krijojë, si të them kështu, ndërhyrje subjektive, për t'i dhënë dikujt më shumë hapësirë se tjetrit. Pra, u tha këtu që në rastet, kur ta zëmë, një biznes e ka një kontest me një institucione publik, pra me shtetin në njëfarë mënyre, atëherë kjo trajtohet ndryshe. U tha, po ashtu këtu, që bizneset e afërta me pushtetin ose persona të caktuar brenda pushtetit pastaj trajtohen ndryshe dhe, kjo është shumë e vërtetë. Domethënë, ekziston një lloj pabarazie në mes të bizneseve dhe po ashtu, mendoj unë, ekziston një pabarazi të sistemi i drejtësisë në mes të sektorëve, pra jo të gjithë sektorët e ekonomisë trajtohen në mënyrën e njëjtë karshi të drejtave që duhet të gëzojnë dhe të garantuara me ligj. Dhe, këto dy çështje të pabarazisë duhet domosdoshmërisht të trajtohen me seriozitet, për ta vlerësuar në fund ne, si Kuvend, nëse kjo pabarazi është ingranuar, të them ashtu, objektivisht nëpër ligjet tona, apo nëse ligjet janë në rregull, po edhe të zbatimi i tyre pastaj kemi probleme të ndërhyrjeve subjektive të individëve të fuqishëm, të cilët e shkaktojnë këtë hapësirë pabarazie në mes të bizneseve apo sektorëve. Dhe, në këtë drejtim mendoj që ne, si Kuvend, duhet të flasim edhe në këtë dimension, pra në dimensionin jo vetëm të krijimit të hapësirës së barazisë për bizneset, zhvillimin e tyre, e kështu me radhë por, edhe në atë se si pastaj këto biznese e ndihmojnë ekonominë e vendit, që është qëllimi përfundimtar i institucioneve publike. Natyrisht, që këtu u fol dhe ka nevojë domosdoshmërisht që lëndët që janë nëpër gjykata, qofshin ato që kanë të bëjnë me çështjet e biznesit, qofshin ato që kanë të bëjnë me çështjet e qytetarëve të përshpejtohen, mirëpo përshpejtimi shpeshherë na ndodh që bëhet në dëm të drejtësisë. Përmbauesi privat, kur është sjellë ligji në Kuvend është mbrojtur ideja e përmbauesve privatë me rritje të efikasitetit, apo jo. Dhe, përnjëmend ka një rritje të jashtëzakonisht të efikasitetit, por në dobi të kujt? Pra, a po na dëmtohet drejtësia me këtë rritje të efikasitetit? Dhe, nëse kjo është e vërtetë, atëherë ne do të marrim masa, në mënyrë që përshpejtimin mos ta bëjmë në dëm të drejtësisë, sepse atëherë e krijojmë një problem të ri, që për mendimin tim, është problem më i madh se sa që e kemi aktualisht. Natyrisht, që shërbimet publike në secilin moment që ato shndërrohen në çështje tregu, atëherë do të na krijohet një situatë e tillë, siç na është krijuar, për shembull, me përmbauesit privatë. Përmbauesit privatë në fund të fundit, meqenëse janë privatë, ata synojnë profitin për vete. Dhe, në këtë drejtim, është rol parësor i institucioneve publike dhe si temë e drejtësisë në këtë rast, që ta garantojë, prapë po kthehem te pika e parë, ta garantojë një hapësirë barazie. Kisha dashur edhe nga përfaqësuesit e bizneseve, në këtë rast ata që i kemi prezentë po edhe të tjerët, që në raportet e tyre edhe të jenë më specifike, më të detajuara, në mënyrë që ne të jemi më mirë të informuar si deputetë, se saktësisht ku është problemi dhe, në anën tjetër, ta kemi një lloj gjithëpërfshirje të sektorëve të ndryshëm, sepse këtu po e shoh, që një pjesë të madhe të atyre që dëgjuam dhe që e kemi të shkruar, vijnë nga disa sektorë të caktuar, për shembull, sepse Shoqata e Bankave e ka raportin më të gjatë, duke i rreshtuar ato probleme që i kanë në sistemin e drejtësisë. Po në anën tjetër, ne e dimë që në sektorin bankar nuk është se kjo mungesë e sistemit ligjor ka ndikuar në mosinteresim të bankave për të hyrë në tregun e Kosovës, apo jo? Ne i kemi, dhjetë banka në tregun e Kosovës për një portfolio të gjithmbarshme 1.8 miliardë. Mendoj, që këtu nuk ka vend për banka të reja, jo se këto janë të dekurajuara nga mungesa e sistemit, ose funksionimit të sistemit të drejtësisë. Pra, nëse kemi një gjendje paligjshmërie në treg, që është evidente, atëherë disa biznese po shfrytëzojnë këtë dhe po përfitojnë prej saj. Dhe, vendosja e ligjshmërisë në këtë drejtim, pastaj do ta dëmtonte interesin e këtyre bizneseve. Pra, nuk po them që nuk duhet të vendoset ligjshmëria, por duhet ta kemi parasysh që edhe ankesat kur vijnë, vijnë me motive të caktuara për të arritur një qëllim të caktuar. Besoj, që kishte me qenë mirë, që të paktën nga ky diskutim ta kemi një lloj kërkesë për informata më të detajuara nga të gjithë aktorët që kanë marrë mundin që t'i shkruajnë Kuvendit për këto çështje, po edhe të tjerët, në mënyrë që pastaj ta kemi një ballafaqim më të saktë të problemeve dhe çështjeve të ngritura nga të gjitha palët.

Sala Berisha – Shala - Tha se e para, konsideroj se është një hap jashtëzakonisht i mirë bashkëpunimi në mes të dy komisioneve si trupa të Kuvendit, Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Vlerësoj se të gjithë bashkërisht jemi të interesuar, që në

Kosovë të ketë një zhvillim sa më të hovshëm ekonomik dhe, ky zhvillim ekonomik varet direkt edhe nga zbatimi i ligjeve, varet edhe nga ajo se çfarë ligjesh kemi nxjerrë ne, si Kuvend i Kosovës, që u përmend nga disa prej kolegëve. Dhe, si deputetë, përveç obligimit parësor që e kemi bërjen e ligjeve, menjëherë obligim tjetër kemi të shohim se sa po zbatohen ato ligje, ku është ngecja, pse nuk po zbatohen, e kështu me radhë. Konsideroj, që nuk duhet ta shohim problematikën e çalimit të këtyre çështjeve, mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë dhe mos zhvillimin ekonomik vetëm nga neglizhenca, ose papërgjegjësia e kësaj qeverie apo e asaj qeverie, po konsideroj, që problematikën e kanë një burim shumë më të hershëm. Ne jemi dëshmitarë të asaj se funksionimi i shtyllave të jetës në Kosovë, sidomos funksionimi i Shtyllës së Dytë, që ka qenë kompetencë më herët e Bashkësisë Ndërkombëtare UNMIK-ut, që është lidhur me drejtësinë dhe Shtylla e Katërt – Zhvillimi Ekonomik, e kemi çalimin më të madh, të cilin e kemi trashëguar dhe nuk po mund të këndellemi aq sa duhet. Dhe, mendoj se kisha me e shtruar një pyetje, se a mund të ecin paralelisht këto dy segmente, drejtësia dhe zhvillimi ekonomik pa e cenuar njëra- tjetrën. Në njëfarë forme e përmendi edhe deputeti Ymeri. Të shohim, se a mund të ecin këto suksesshëm, pa lënduar njëra- tjetrën, ose cilat janë mundësitë tona, që ta bëjmë një ecje të tillë, që këto dyja të jenë si shtytëse e njëra tjetrës dhe jo anasjelltas. Duhet të shohim, ne kemi mundësinë që të dimë dhe të ndihmojmë diçka në këtë drejtim. Dhe, mungesa e burimeve njerëzore dhe stafit profesional në gjyqësor, që është identifikim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Mendoj që si deputetë bashkërisht, nuk duhet të jetë ky takim i fundit, po duhet të vazhdojmë me një praktikë të tillë dhe problemet e identifikuara, ku janë, atëherë vijmë më lehtë deri te alternativat e zgjedhjes së tyre.

Blerim Grainca - Tha se që nga fillimi pak e kemi dështuar temën, mendoj se jemi zgjeruar më shumë nga dëshira për t'i parë gjërat më mirë, sepse ne fillimisht jemi përcaktuar që të flasim për kontestet biznesore, për problemet që ka komuniteti i biznesit me gjykatat, ndërsa këtu i ngritën dhe çështje të cilat e tejkalojnë këtë fushë, dalin jashtë suazave të asaj për të cilën jemi marrë donim të bisedonim sot. Dhe, nga krejt kjo që u tha këtu, duke dashtë me përdorë edhe një gjuhë pak më politike dhe pak më të moderuar, megjithatë mendoj se janë dy probleme kyçe që i kanë gjykatat e Kosovës, që karakterizohen me jo funksionalitet e ato janë: burokracia e madhe që ekziston në këto gjykata dhe shkalla e lartë e korrupsionit. Duhet me i thënë gjërat pak më hapur, për arsye se ju e dini, sot nëse ndodh një kontest në gjykatë, e para gjë njerëzit kanë humbur besimin te gjykata dhe pyetja e dytë që bëhet me automatizëm është, nuk pyetet cili është rezultati, po pyesin cili është gjyqtari, sepse varësisht se te cili gjyqtar e ke lëndën e din edhe rezultatin final të asaj se si do të përfundojë kontesti gjyqësor. Gjykatat tona kanë tretman jo të barabartë ndaj lëndëve, veçanërisht nga ajo se kush janë palë në biznes. Për shembull, kanë tretman jo të barabartë, kur po flasim për dy biznese, kur kemi të bëjmë me një kontratë të pazbatueshme apo e cila është shkelur nga dy biznese, atëherë varësisht nga ajo se cili biznes ka një lidhje në gjykatë, kjo rezulton pozitivisht për atë. Pastaj, kemi edhe raportin biznes në institucione, që u përmend këtu e që unë mendoj se të shumtën e rasteve, fitues të këtyre kontesteve janë bizneset, jo institucionet, veçanërisht kur bëhet për institucionet publike, kryesisht kontestet i fitojnë bizneset. Dhe e treta, ajo që lidhet me kontestet në mes bizneseve vendore dhe ndërkombëtare, gjë që unë mendoj se ka pak konteste të tilla. Prandaj, këto tri fenomene, tri probleme kryesore që kanë gjykatat tona, janë kryekëput të lidhura me dy shkaqet apo shkasat, që i përmenda në fillim e që janë burokracia dhe korrupsioni.

Agim Aliu - Tha se mendoj, se duhet të përfundojmë këtë takim aty, ku në fakt e nisëm, te qëllimi që është i këtij takimi dhe qëllimi i këtij takimi, gjithsesi se është i njëjtë me atë që është pak a shumë edhe qëllimi i vetë bizneseve, që në fakt, ne, si deputetë, dhe si përfaqësues jo vetëm të qytetarëve, po edhe të komunitetit të bizneseve, jemi e njëjta palë dhe siç u tha këtu, do të duhej ta bënim monologun, po do të duhej ta bënim dialogun dhe u dakorduam që të bëjmë edhe dialogun me përfaqësuesit kompetentë, në mënyrë që të ndryshohet kjo situatë e cila është. Unë mendoj, se nuk do të duhej të vazhdonim të bënim gjyqin, sepse gjyqi është bërë vetë nga e

kaluara dhe u tha edhe këtu dhe, në mënyrë laksative apo përshkruese janë të evidentuara problemet, sepse ajo nuk mund të ndryshohet, e kaluara nuk mund të ndryshohet. Por, ajo që mund të bëhet është e tashmja dhe e ardhmja dhe unë mendoj, se kjo është detyra, obligimi dhe përgjegjësia jonë, që të ndryshohet e tashmja dhe e ardhmja. Pra, unë kisha kërkuar nga ne, të gjithë deputetët, po edhe mekanizma tjerë mbështetës, që ne të bëjmë hapat e duhur që të ndryshohet kjo klimë e bizneseve, respektivisht afarimi i tyre. Por, ajo që dua të them është se sot ky takim e vërteton edhe një gjë, që drejtësia nuk është selektive në kuptimin e çështjeve të bëra keq, në kuptimin vetëm për bizneset, sepse si Komision për Legjislacion kemi diskutuar dhe është e njëjta situatë edhe në sektorët tjerë. Pra, kemi të bëjmë me një strukturë të ngjashme, me një mentalitet të ngjashëm dhe pak a shumë janë ato probleme, që u thanë edhe nga parafolësi im. U shtrua çështja e buxhetit dhe dua ta lidhi me çështjen e kompetencave. Unë nga ajo që e kam parë, shpesh na ka ndodhur në institucione se nuk është që s'kemi pasur buxhet sa kemi pasur jo menaxhim të mirë të atij buxheti. Por, nëse vërtet konstatohet këtu se Këshilli Gjyqësor, institucionet e drejtësisë kanë mungesë të buxhetit, unë mendoj se të dy këto komisione janë pikërisht ato që mund ta procedojnë në Kuvend dhe pastaj të mos hidhet faji se është te buxheti, sepse mua po më duket sikur po kërkohet një fajtor kujdestar, që ja këtu është problemi, është buxheti dhe ju i keni fajet që nuk po e miratoni buxhetin. Unë mendoj që kemi bërë disa hapa si Komision sa i përket çështjeve të drejtësisë dhe thashë se jemi çuditur dhe unë për veten jam për herë të parë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe jam çuditur se si edhe pas 15 viteve nuk janë normuar si duhet procedurat e përzgjedhjes së gjyqtarëve, e përzgjedhjes së Këshillit Gjyqësor. Unë mendoj se kjo do të duhej të ndryshonte dhe ne kemi diskutuar se si mund ta bëjmë këtë, e cila pastaj do të derivonte me një funksionalizim më të mirë pavarësisht të gjitha problemeve që i diskutuam e që i ka gjyqësia sot. Dua t'i referohem pak çështjes që e ngriti zoti Krasniqi shuarjes së bizneseve. Nëse mund të flasim për shuarjen pastaj do të pyesim edhe sa janë shtuar dhe nuk mund ta marrim si një çështje referimi këtë se janë shuar sepse ju shumë mirë e dini që kemi numër shumë më të madh të bizneseve që janë edhe fiktive, që nuk afrojnë, por bizneset aktive, ju e dini sa është numri i tyre dhe në fakt ne presim që të shuhen edhe biznese të reja, por kjo nuk e pasqyron gjendjen reale me një shuarje të një biznesi dhe po krijohet kjo klimë apo ajo klimë. Pra, realisht ai është një proces normal. Këtë e kemi parë, edhe kryetari Pal Lekaj, kur kemi qenë kryetar komunash se është një proces që realisht ndodh. Por, shqetësuese dhe unë mendoj se do të duhej të ishin rekomandimet nga ky takim që vërtet në takimet e ardhshme, që u tha ky është takim nismëtar, por të pasuar me takime tjera, janë çështje të raportimit edhe të Këshillit Gjyqësor që sado kudo ne i dimë se çfarë do të raportohet, por do të mbetet detyrë e Komisionit për zhvillim ekonomik dhe të legjislacionit që nëse ka nevojë ligjet aktuale t'i rishikojë në ndryshim dhe plotësim, t'i amendamentojë me amendamente që ju konsideroni se janë në favor të një klime më të përshtatshme, sepse duhet ta pranojmë faktin që shumë shqetësuese është që mungesa e legjislacionit adekuat është duke i detyruar jo tashmë bizneset e huaja të ikin nga Kosova, por fatkeqësisht bizneset e Kosovës janë duke ikur jashtë. Të huajat, është tregim në vete, por bizneset e Kosovës janë duke ikur në Maqedoni dhe unë mendoj që ndoshta pikërisht nga legjislacioni i Maqedonisë do të duhej të marrim shembuj se çfarë kushti kanë krijuar ato biznese që ne praktikisht ta ndryshojmë këtë klimë.

Lumnije Hajdini, Aleanca Kosovare e Bizneseve - Tha se kemi pasur shumë probleme për bizneset e mirëfillta që t'ia rrisim besimin, që t'i trajtojnë apo t'i diskutojnë hapur lëndët e tyre, sa u përket gjykatave. Ky ka qenë problemi esencial dhe po vazhdon të jetë edhe në të ardhmen. U fol për shumë çështje dhe ne do t'i përcjellim të gjitha, sepse janë dy komisione këtu shumë të rëndësishme, Komisioni për legjislacion dhe Komisioni për zhvillim ekonomik. Këtu do të thotë kemi të bëjmë me shumë çështje që ne, për shembull, vitin e kaluar kemi qenë kryesues të Këshillit të ATK, Dogana, Ministria e Financave si dhe përfaqësuesit e organizatave biznesore. Me përgjegjësi të lartë po e them, ka pasur mbi 274 biznese – prodhues të Kosovës që kanë pasur raste në gjykata, po mendoj raste në shkallën e parë të Administratës doganore, kanë kaluar shkallën e dytë, janë dënuar dhe mandej kanë kërkuar garanci bankare për shkak të importit të

lëndës së parë dhe asnjëherë, do të thotë, nuk janë zgjidhur deri sa e kanë realizuar importin e lëndës së parë apo të pajisjeve. Sa i përket ATK-së, po ashtu janë të njëjta, do të thotë, dy administrata shtetërore dhe këtu kemi ardhur në përfundim se shumica e prodhuesve mendojnë se trajtimi është selektiv nga administrata shtetërore. Sa i përket zbatimit të kontratës të investitorët. Pyetja e parë dhe diskutimi i parë në të gjitha shtetet ka qenë: Në Kosovë nuk po zbatohet kontrata, në të gjithë sektorët. Domethënë kjo është ajo që pse nuk po vijnë investimet e huaja këtu në Kosovë. Ne e kemi bërë një hulumtim që e është në 2010-2014. Po flasim për kompanitë të cilat janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve 129 mijë, mirëpo janë 66.800 që janë në Administratën Tatimore aktive. Mirëpo në këto 4 mijë neve na ka interesuar pse investitorët e huaj po ikin, nuk po vijnë në Kosovë dhe pse investitorët vendorë po shkojnë në Maqedoni, por edhe në Bullgari? Ka edhe shumë e shumë, por ne si Aleancë vërtet do të kemi bashkëpunim dhe shumë shpresoj se do të kontribuojmë në të gjitha lëndët që i kemi ne dhe që i kemi trajtuar qoftë në dy organizatat shtetërore – Doganë – ATK dhe në gjyqësor e të gjitha këto do t'i adresojmë te ju dhe besoj e shpresoj se do të kemi një përmirësim të vogël, sepse nuk pres për përmirësim shumë të madh dhe kisha dashur që asnjëherë mos t'ia bartim fajin askujt, por ta rrisim besimin se ndoshta është koha e fundit që ne duhet ta kemi, sepse ka biznese dhe me përgjegjësi të plotë po them, edhe në Bullgari janë 16 biznese që do ta transferojnë teknologjinë e tyre në vendet e rajonit, e po ashtu edhe të Malit të Zi.

Fatmir Rexhepi - Tha se Komisioni, me marrjen e një vlerësimi që të mbahet ky takim, ka pasur për qëllim që të hapë debatin për këtë temë shumë të rëndësishme e cila e ka përcjellë ekonominë e vendit, i ka përcjellë bizneset dhe gjithë ambientin ekonomik në vend, me qëllim që mundësisht të bëhet një renditje e të gjitha detyrave që dalin për Kuvendin, për Qeverinë, por edhe për neve, si pjesë e këtyre institucioneve, por edhe e gjykatave që të ndryshohet dhe përmirësohet kjo situatë e cila është e pakënaqshme. Atëherë, shtrohet çështja si ta avancojmë këtë punë, ta vëmë me prioritet në renditje, t'i rendisim punët mirë dhe ta bëjmë ndonjë punë e cila kishte me dalë me dobi edhe për biznesin edhe për institucionet. Mendoj se llogari në radhë të parë për këto punë duhet kërkuar nga Qeveria. Jo të gjitha qeveritë, sepse ne jemi ata të cilët bëjmë kontratën politike, kontratën programore, kontratën zhvillimore dhe kontratën e investimeve qoftë me qytetarin tonë, qoftë me biznesin tonë, qoftë me investitorët e huaj. Pra, është ky projekt i madh të cilin çdo qeveri e merr para vetes dhe del e merr votën e vjen në Parlament, e pastaj ku ngel hesapi? Po ngel puna, pra në të gjitha ato barriera të cilat janë në detyrë të qeverisë e nuk po i zgjidh. S'është hera e parë, janë 15 vjet. Merre cilëndo qeveri, mendoj se në këtë plan kanë dështuar. Prandaj, mendoj se kjo punë na pret dhe është mirë që edhe rekomandimet tona sot me i nxjerr në këtë drejtim dhe me ndenjur në kontinuitet, mos me e harruar këtë temë, shumë me rëndësi për komisionin tonë. Mendoj se në ato vende ku bankat kanë probleme, mos pritni se do të zhvillohet ai vend, pavarësisht opinioneve apo vlerësimeve që jepen se çka është banka për biznes. Por në ato vende unë po them ku bankat kanë probleme dinë se biznes nuk ka, prandaj mos me i dhënë tretman tjetër, trajtim tjetër. Unë mendoj se ka shumë rëndësi që këto politika të ndryshohen, që të sigurohet çështja e zgjidhjes së këtyre lëndëve nga ana e bankave qoftë për qytetarin, qoftë për biznesin, qoftë për bankën në mënyrë që ta kemi një besim shumë më të madh, sepse pa kredi nuk ka biznes. A janë kushtet e mira, a janë kushtet e rënda e të vështira, kjo është një temë krejt tjetër që duhet të garantohet, pra që edhe banka të ketë garancitë e veta në mënyrë që punët të shkojnë më mirë.

Kryetari i Komisionit z. Muhamet Mustafa - Tha se ky debat e arsyetoi intencën tonë të përbashkët që ta trajtojmë këtë problem. Prandaj, detyrë kryesore e jona si deputetë, por edhe i Qeverisë dhe subjekteve tjera është që të shohin rrugëdaljen. E rrugëdalja në këtë sferë është që ne duhet të kërkojmë nga sistemi gjyqësor dhe nga gjykatat që të aftësohen dhe ne t'i ndihmojmë me gjithçka që duhet, që të aftësohet, që trajtimin e kontesteve biznesore prej disa vjet ta shndërrojnë në disa muaj. Kjo është kërkesa jonë. Dhe kjo është përgjegjësi e jona, e deputetëve. Duhet të na tregojë Ministria e Drejtësisë, duhet të na tregojnë të gjithë aktorët tjerë, çka i duhen.

A është fakti se ligjet janë problem? Atëherë, shumicën e ligjeve i kemi këtu. E dyta. Gjyqtarët! Cili është ky numër i gjyqtarëve. Në qoftë se i kemi 3 gjyqtarë në një departament që merren me çështje ekonomike, kjo është shumë e qartë, sikur kur i thua mos i realizo lëndët. Kjo është shumë e qartë. Me i pas vetëm lëndët e bankave, 10 mijë lëndë 3 vetë? Po tjerat lëndë? Do të thotë, shumë e qartë është kjo. Ne nuk mund ta tolerojmë këtë situatë të tillë, ne duhet ta demistifikojmë, ta zbulojmë dhe të shohim çka të bëjmë që ta tejkalojmë këtë situatë. Përndryshe, ne flasim kot për konkurrencën fer ose për zbatim të kontratave. Ju lutem, dy gjërat elementare, konkurrenca fer, zbatimi i kontratave janë a dhe b të zhvillimit ekonomik. A dhe b e ekonomisë së tregut. Në qoftë se nuk ka barazi në treg dhe zbatim të kontratave, nuk ka ekonomi të tregut dhe ne vetëm flasim kot. S'ka ekonomi të tregut. Ka ekonomi të klientilizuar. Të shohim gjyqtarët dhe stafin mbështetës, sa gjyqtarë janë, krejt merren me këto probleme, cili është stafi i tyre mbështetës. Na duhet të vijmë diku në një standard, për shembull. Të shohim një gjykatës sa lëndë duhet t'i kryejë në vit. Shembull, ekzistojnë në rajon standarde, dhe në Evropë, e ne nuk duhet të presim që një gjykatës i yni të jetë një supremen dhe të kryejë me 10 mijë lëndë brenda vitit. Ekziston një normë, në vendet ku zbatohet ligji, një gjykatës sa pritet t'i ketë lëndë në vit. Ne duhet të fillojmë që ta identifikojmë ku është problemi, ta tejkalojmë këtë situatë sepse përndryshe nuk mund të kërkojmë tjetër. Mund ta kursejmë buxhetin gjithkund, por këtu në qoftë se e kursejmë buxhetin me numrin e gjykatësve dhe stafin mbështetës në këtë çështje, ne e kemi zvogëluar mundësinë e investimeve në Kosovë. Mendoj se stafi ynë profesional i Komisionit do t'i merr këto çështje dhe ka edhe studime edhe nga USAID që kanë bërë hulumtime për këtë dhe do t'i shfrytëzojmë të dhënat materiale, dhe ta përgatisim një raport dhe të çojmë rekomandime në Kuvend për këto tri çështje, çka duhet bërë te ligjet, çka duhet te numri i gjykatësve dhe çka duhet te buxheti i gjyqësorit?

Pas debatit, të dy Komisionet nxorën këtë

Konkluzion

Të hartohet një Raport që përfshin analizë nën: 1. Legjislacionin që mbulon fushën e gjyqësorit; 2. Numrin e gjykatësve dhe të stafit mbështetës të tyre; dhe 3. Buxhetin e gjyqësorit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa